



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:246359

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05493265

CP.nr.0155/2012

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Hajrullah Aruqi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, tani Telekom i Kosovës -Vala, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit M.H., me nr. personal..., nga fshati..., komuna Skenderaj, për borxh në shumën prej 216.84 euro, jashtë seancës gjyqësore, me datë 22.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përmbartimore e kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A, tani Telekom i Kosovës -Vala, me seli në Prishtinë, ndaj debitorit M.H., nga fshati..., komuna Skenderaj, për borxh në shumën prej 216.84 euro (dyqind e gjashtëmbëdhjetë euro e tetëdhjetë e katër cent).

A r s y e t i m

Gjykata me Aktvendimin CP.nr.0155/2012 me dt.30.05.2012 e ka lejuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh.A.-Vala me seli në Prishtinë, ndaj debitorit M.H., nga fshati..., komuna Skenderaj, për borxh në shumën prej 308.24 euro, ndërsa me parashtrësën e dt.26.02.2024 kreditori e bëri precizimin e borxhit, ku theksuan se borxhi aktual i debitorit është në shumën prej 216.84 euro.

Debitori e ka njoftuar gjykatën se e ka përmbushur borxhin në tërësi, kjo dëshmohet përmes dëftesave të lëshuara nga Telekom i Kosovës nr.73249630 e dt.22.03.2024 e cila është në shumën prej 216 euro, dëftesa nr.73249847 e dt.22.03.2024 në shumën prej 0.50 euro, si dhe taksën gjyqësore në shumën prej 15 euro me numër të pagesës 15356744-2022-Skenderaj, e lëshuar nga Posta e Kosovës dt.12.09.2022.

Gjykata duke u bazuar në nenin 66 par.4 të LPP-së, në të cilin është përcaktuar se “Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxjerret vendim për përfundimin e procedurës përmbartimore”, andaj nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
CP.nr.0155/2012, me dt.22.03.2024

Gjyqtari
Hajrullah Aruqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.